



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS
KRYESIA E KËSHILLIT**

Nr. 3849 Prot.

Patos më, 18/10 /2024

PROJEKT- VENDIM

Nr. 76, datë 18/10.2024

**“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT
VENDORË TË NDERIT”**

Në zbatim të nenit 8, të pikës 1.1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 9, të shkronjës “a” dhe “m” të nenit 54, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Kryesia e Këshillit

PROPOZON:

1. Të miratohet ngritja e Komisionit Këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit të Bashkisë Patos.
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të emërtuar si më poshtë:
 - a) Z. Artan Velçani
 - b) Znj. Vjollca Kasaj
 - c) Znj. Enkelejda Ajazi
 - d) Z. Kozma Sako
 - e) Z. Kastriot Beharaj
3. Komisioni Këshillimor ka për detyrë shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratave medaljeve dhe titujve vendorë të nderit të Bashkisë Patos.
4. Komisioni ka një mandat njëvjeçar nga data e krijimit të tij.

Kryesia e Këshillit

Zy/kryetar
Albiona Lamaj

Anëtarë
Erald Çepele

Anëtarë
Enkelejda Ajazi

Zv/kryetar
Eduart Faslliaj

Kryetar
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS
KRYESIA E KËSHILLIT**

Nr. 3849 Prot.

Patos më, 18/10 /2024

RELACION

Mbi projektvendimin “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Bashkinë Patos”.

Në zbatim të nenit 8, të pikës 1.1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 9, të shkronjës “a” dhe “m” të nenit 54, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendorë”, ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, Kryesia e Këshillit propozon të miratohet ngritja e Komisionit Këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit të Bashkisë Patos

Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të emërtuar si më poshtë:

- a) Z. Artan Velçani
- b) Znj. Vjollca Kasaj
- c) Znj. Enkelejda Ajazi
- d) Z. Kozma Sako
- e) Z. Kastriot Beharaj

Krijimi i komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Bashkinë Patos është një detyrim ligjor i cili rrjedh në bazë të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nga VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë. Përbërja e këtij komisioni në bazë të ligjeve të sipërcituar miratohet me vendim të këshillit të bashkisë Patos dhe në përbërjen e tij duhet të jenë 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve 3 (tre) anëtarë janë punonjës në varësi të autoritetit përgjegjës dhe 2 (dy) anëtarë personalitete të jashtme, që përzgjidhen mes njerëzve të shquar dhe që kanë dhënë kontribut në fushën përkatëse.

Komisioni është përgjegjës sipas ligjit për administrimin e propozimeve për tituj nderi, i vlerëson ato dhe ja paraqet këshillit mendimin e tij për shqyrtimin e mëtejshëm.

Vendimet e komisionit janë të rëndësishme dhe për këshillin pasi anëtarët janë ekspert të fushave të ndryshme dhe paraprakisht studiojnë dokumentacionin përkatës të subjekteve që propozojnë dhënien e titujve të nderit dhe medaljeve.

Personat e ngarkuar të cilët do të jenë dhe pjesë përbërëse e këtij komisioni duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të angazhuar në detyrat e ngarkuara.

Në këto kushte i kërkojmë këshillit të bashkisë të miratoj ngritjen e komisionit Komisionit Këshillimor për medaljet dhe titujt vendorë të nderit të Bashkisë Patos.

Kryesia e Këshillit

Zv/kryetar
Albiona Lamaj

Anëtarë
Erald Çepele

Anëtarë
Enkelejda Ajazi

Zv/kryetar
Eduart Faslliaj

Kryetar
Armand Ahmetaj

